

SL 03 EPOXY



PERSHKRIMI

Vetënivelues me bazë epokside, 2 komponentësh.

KARAKTERISTIKAT

SL 03 EPOXY është një produkt nivelizues me bazë çimento dhe rezinash epokside, si dhe nuk përmban solvent. Ofron avantazhet e mëposhtme:

- Rezistenca të larta mekanike.
- Lidhje shumë e mirë me sipërfaqen ku aplikohet.
- Rezistencë e lartë ndaj lagështirës.
- Ka aftësi shumë të mira nivelizuese.
- Nuk ka efekt korrodues.
- Klasifikohet si CT - C50 - F10 - AR0,5 sipas EN 13813.

FUSHAT E APLIKIMIT

SL 03 EPOXY përdorët për riparime dhe nivelizimin e sipërfaqeve që do përdoren për: shtresë poliuretani, dysheme PVC, laminat, parket druri etj. SL 03 EPOXY aplikohet kur betoni është relativisht i freskët, për të krijuar sipërfaqen e duhur (me të paktën 2 mm trashësi) për aplikimin e shtresave epokside, për të shmangur problemet me shkëputjen, etj. Gjithashtu, është e përshtatshme si shtresë përfundimtare, në një trashësi deri në 3 mm, për sipërfaqe të lëmuara, nivelim dhe për të rritur rezistencën e sipërfaqes ndaj ngarkesave mekanike.

KARAKTERISTIKA TEKNIKE

Forma:	Komponenti A Paste Komponenti B Leng
Ngjyra	Sipas katalogut RAL
Raporti pezierjes:	5A : 1B : 25 C
Densiteti Komp A:	1.65 ± 0.10 Kg/l
Densiteti Komp B:	1.05 ± 0.10 Kg/l
Koha e punueshmerise:	Afersisht 1 ore
Forca ngjitesë (EN 13892-8):	4.2 N/mm ²
Rezistenca ne ngjeshje(EN 13892-2):	
• Pas 4 oresh:	20 N/mm ²
• Pas 24 oresh:	40 N/mm ²
• Pas 7 ditësh:	69 N/mm ²
• Pas 28 ditësh:	104 N/mm ²
Rezistenca ne perkulje (EN 13892-2):	
• Pas 4 oresh:	12 N/mm ²
• Pas 24 oresh:	37 N/mm ²
• Pas 7 ditësh:	59 N/mm ²
• Pas 28 ditësh:	74 N/mm ²
Rezistenca ndaj gerryerjes::	
• Pas 28 ditësh:	≤ 50 µg
Tkurra (EN 13872):	
• Pas 28 ditësh:	max 0.25 mm/m

PËRGATITJA E SIPËRFAQES

Sipërfaqja ku do të aplikohet duhet të jetë:

- E qëndrueshme dhe e thatë ose me pak lagështi, pa praninë e ujit.
- E pastër, pa materiale që parandalojnë lidhjen, të tilla si pluhur, grimca të lirshme, yndyrna, etj. Për sipërfaqe shumë absorbuese ose poroze, sipërfaqja duhet të trajtohet me astarin epoksid me bazë uji EPOXY PRIMER W - 4000, siç është ose i holluar me 10% ujë. Astari aplikohet me furçë ose rrul në një shtresë. Aplikimi i SL 03 EPOXY vijon pasi astari mund të shkelet.

PËRGATITJA E PËRZIERJES

Komponentët A dhe B janë paketuar në proporcione të paracaktuara përzierjeje. Fillimisht, komponenti A duhet të përzieret mirë në enën e tij dhe më pas duhet të zhvendoset në një enë të pastër prej përafërsisht 30 litra vëllim. Më pas e gjithë sasia e komponentit B duhet të shtohet në komponentin A. Është e rëndësishme që të bëhet një përzierje e mirë pranë anëve dhe në fund të kovës, për të arritur shpërndarje uniforme të forcuesit. Nuk duhet të shtohet ujë në përzierje.

APLIKIMI

SL 03 EPOXY duhet të aplikohen në një trashësi deri në 3 mm duke përdorur një mallë me dhëmbëza. Në mënyrë që të largohet ajri brenda shtresës vetëniveluese, sipërfaqja duhet të kalohet me një rrul të veçantë me gjemba. Kjo parandalon formimin e fluskave dhe ndihmon për të arritur një trashësi uniforme..

PASTRIMI I MJETEVE

Mjetet duhet të pastrohen me ujë menjëherë pas përdorimit. Materiali i fortuar mund të hiqet vetëm mekanikisht.

RUAJTJA

24 muaj nëse ruhet në paketim origjinal dhe të pahapur i pa ekspozuar ndaj rrezeve të diellit dhe ngricës.

PAKETIMI

SL 03 EPOXY është i disponueshëm në paketim 5kg dhe 15kg.

KONSUMIMI

200 - 300 g/m².

INFORMACION MBI SHËNDETIN DHE SIGURINË

Mbajeni larg fëmijëve. Në rast kontakti me sytë ose gjellitjeje, kërkoni menjëherë ndihmë mjekësore dhe tregoni përmbajtjen e enës. Mos e hidhni produktin në kanalizime.

